



RAPORT PËRMBLEDHËS I AKTIVITETEVE TË PLATFORMËS CIVIKOS PËR VITIN 2017

Dhjetor 2017



PËRMBAJTJA

DONATORËT.....	1
LISTA E AKRONIMEVE.....	1
CIVIKOS GJATË 2017 – INFORMATA DHE FAKTE TË SHKURTËRA.....	2
BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE – QEVERI.....	3
DISA NGA TË ARRITURAT DHE SFIDAT KRYESORE NË ZBATIM TË STRATEGJISË QEVERTARE	3
AKTIVITETET E PLATFORMËS CIVIKOS.....	4
CIVIKOS ME MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME MINISTRINË E TREGTISË DHE INDUSTRIË.....	4
KUVENDI VJETOR I CIVIKOS.....	5
STRATEGJIA E PLATFORMËS CIVIKOS 2018-2022.....	6
PROCESI I PËRZGJEDHJËS SË ANËTARËVE TË SHC-së NË TRUPA TË NDRYSHËM PUBLIK.....	6
PROMOVIMI I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (SDG) NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE	8
ANGAZHIMI I CIVIKOS NË PROJEKTIN E USAID KOMUNAT TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE (TEAM)	9



DONATORËT

Sekretariati i Platformës CiviKos gjatë vitit 2017 është mbështetur financiarisht nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), nga ambasada e Mbretërisë së Holandës, Misioni i OSBE-së në Kosovë, UNDP në Kosovë, TACSO Zyra në Kosovë, dhe po ashtu është nën-kontraktuar nga DAI për zbatimin e aktiviteteve të Komponentës së tretë – Mundësimi i Shoqërisë Civile për të hulumtuar dhe raportuar mbi korrupsionin, si pjesë e projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM).

LISTA E AKRONIMEVE

CiviKos	Platforma CiviKos
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
KFOS	Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
ZQM/KM	Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
Strategjia Qeveritare	Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017
Strategjia e CiviKos	Strategjia e Platformës CiviKos 2015-2017
Këshilli	Këshilli për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile

CIVIKOS GJATË 2017 – INFORMATA DHE FAKTE TË SHKURTËRA

- 216 organizata anëtare në CiviKos;
- Bordi i Platformës CiviKos gjatë vitit 2017 ka mbajtur 6 takime;
- Gjatë vitit 2017 Sekretariati i Platformës CiviKos ka publikuar raportin: *Konsultimi Publik me Organizatat Anëtare të Platformës CiviKos për vitin 2016*.
- Gjatë muajit prill 2017 së bashku me 5 Qendrat Rajonale, Sekretariati i CiviKos ka organizuar një raund të konsultimeve me organizatat e shoqërisë civile, rreth procesit të bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri.
- Gjatë muajit maj 2017, CiviKos organizoi Kuvendin Vjetor të anëtarëve dhe përzgjedhi katër anëtarë të rinj të Bordit (Ariana Qosaj Mustafa, Luljeta Demolli, Bujar Kadriu dhe Zana Hoxha Krasniqi).
- Me 02.02.2017 Drejtoresha Ekzekutive e Platformës CiviKos Valdete Idrizi nënshkroi memorandum bashkëpunimi me Ministren e Tregtisë dhe Industrisë Znj. Hykmete Bajrami, rreth monitorimit të prokurimit nga organizatat e shoqërisë civile.
- Gjatë pjesës së dytë të vitit 2017, Sekretariati i Platformës CiviKos ka organizuar 5 trajnime në 5 rajone të Kosovës rreth Monitorimit të Prokurimit Publik si pjesë e projektit të USAID TEAM. Si pjesë e këtyre trajnimeve, më shumë se 100 OSHC lokale janë trajnuar si të monitorojnë procesin e prokurimit publik në komunat e tyre.
- CiviKos ka përgaditur Planin Strategjik për vitin 2018 – 2021, i cili pritet të aprovohet në fillim të vitit të ardhshëm nga anëtarët e CiviKos.
- CiviKos gjatë vitit 2017 ka vazhduar të përkrahë organizatat anëtare, duke iu ofruar shërbimin informues (ndarja e informatave për grante, dhe informata relevante për shoqërinë civile) si dhe ofrimin e hapësirës për takime, si dhe duke iu ndihmuar në vendosjen e kontakteve në mes OSHC-ve.

SFIDAT:

- Me 22.08.2017 Drejtoresha Ekzekutive e Platformës CiviKos, znj. Valdete Idrizi ka dhënë dorëheqje nga Platforma CiviKos. Në përputhje me përgjegjësitë e veta statutare, Bordi i Platformës CiviKos menjëherë ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e punës së Platformës CiviKos. Obligimet dhe detyrat e Platformës CiviKos vazhdojnë të trajtohen në baza të rregullta nga Sekretariati i CiviKos.
- Zbatimit i Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 është në periudhën e fundit. Përderisa një pjesë e objektivave strategjike kanë shënuar arritje të dukshme dhe që janë vlerësuar pozitivisht nga organizatat e shoqërisë civile sic është platforma online për procesin e konsultimit publik, publikimi i raportit rreth ndarjes së fondeve publike për oshc, aprovimi i rregullores së re për ndarjen e fondeve publike, zbatimi i një pjese të konsiderueshme të aktiviteteve të kësaj strategjie ende mbetet sfidë.

BASHKËPUNIMI SHOQËRI CIVILE – QEVERI

Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013 – 2017

Sekretariati i Platformës CiviKos përveç koordinimit të aktiviteteve për zbatim të Strategjisë Qeveritare, ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e Strategjisë Qeveritare, si dhe ka lehtësuar pjesëmarrjen e anëtarëve të shoqërisë civile në tërë procesin. Të dhënat nga matrica e monitorimit janë shfrytëzuar nga anëtarët e shoqërisë civile në Këshill për të krijuar një pasqyrë më të qartë të zbatimit të Strategjisë Qeveritare.

Gjatë vitit 2017 Këshilli për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile ka mbajtur 3 takime të rregullta.

5 Tetor 2017 është mbajtur takimi i Këshillit me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj. Në këtë takim përveç anëtarëve të Këshillit nga qeveria dhe shoqëria civile pjesëmarrës ishin edhe anëtarët e Bordit të CiviKos, ku Kryeministri u njoftua për së afërmi me progresin dhe sfidat në zbatim të Strategjisë Qeveritare.

Grupet e punës të Këshillit kanë mbajtur takime në mënyrë të vazhdueshme, duke kontribuar në zbatim të aktiviteteve të objektivave strategjike.

DISA NGA TË ARRITURAT DHE SFIDAT KRYESORE NË ZBATIM TË STRATEGJISË QEVERITARE

-Gjatë muajit Shkurt 2017 lëshohet për përdorim Platforma online për procesin e konsultimit publik

Platforma online për organizimin e konsultimit publik vjen si rezultat i punës së përbashkët në kuadër të bashkëpunimit shoqëri civile - qeveri, respektivisht Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017. Kjo platformë ofron mundësi për të gjitha palët e interesuara që të përfshihen në proceset e politikë-bërjes në pajtim me Rregulloren nr. 05/2016 mbi Standardet Minimale për procesin e konsultimit publik.

-Gjatë muajit Mars 2017-12-06 publikohet raporti i parë për financim publik të OSHC-ve nga insitucionet publike.

Transparenca në ndarjen e fondeve publike ka qenë kërkesë e vazhdueshme e organizatave të shoqërisë civile, si dhe është pjesë e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile. Publikimi i këtij raporti është një hap në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies rreth ndarjes së fondeve publike për OSHC-të.



-Gjatë muajit Qershor 2017 miratohet Rregullorja mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (MF-NR. 04/2017).

Kjo rregullore shënon një hap të rëndësishëm përpara duke diktuar rregullat për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile përmes fondeve publike, sipas standardeve të transparencës, meritokracisë dhe zbatimit të plotë të ligjeve në fuqi.

Disa nga sfidat në zbatim të Strategjisë Qeveritare:

- Mos ndarja e buxhetit nga Qeveria për zbatim të Strategjisë Qeveritare;
- Pjesëmarrje e ulët e anëtarëve të Këshillit nga Qeveria në proces;
- Kapacitete të limituara të ZQM për koordinim të zbatimit të Strategjisë Qeveritare;
- Mungesa e një sistemi të mirëfilltë të monitorimit të Strategjisë nga ana e ZQM;
- Progres i ulët i zbatimit të aktiviteteve për objektivën e II-të dhe IV-të.

AKTIVITETET E PLATFOMËS CIVIKOS

CiviKos nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Gjatë muajit shkurt 2017 Platforma CiviKos ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Qëllim i këtij memorandum është vendosja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm mes organizatave të shoqërisë civile dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në ngritjen e transparencës së plotë gjatë gjithë procesit të dhënies së kontratave publike, procedurave të prokurimit publik, dhe tenderimit në MTI.

Ky bashkëpunim kontribuon në mënyrë direkte në zbatim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile, dhe në mbrojtje të konsumatorit. Përfaqësuesit e shoqërisë civile që do të jenë vëzhgues në komisionet vlerësuese në proceset e prokurimit publik të cilat zhvillohen brenda MTI-së do të për zgjidhen me procedura të hapura dhe demokratike që Platforma CiviKos i promovon me të gjitha institucionet publike.

KUVENDI VJETOR I CIVIKOS

Platforma CiviKos mbajti Kuvendin vjetor, më 30 maj 2017 në “Hotel Sirius” në Prishtinë, ku morën pjesë një numër i madh i organizatave anëtare.

Kuvendin e shpalli të hapur kryesuesi i Bordit, z.Taulant Hoxha i cili bëri një prezantim rreth punës së Bordit të mandatit të kaluar. Drejtoresha Ekzekutive e Platformës CiviKos, znj. Valdete Idrizi, raportoi për



punën dhe aktivitetet e Platformës CiviKos gjatë vitit 2016 si dhe u prezentua edhe raporti financiar. Ajo poashtu shpalosi edhe planin e punës së Platformës CiviKos për vitin 2017.

Gjatë këtij Kuvendi u votua për katër anëtarë të rinj të Bordit të CiviKos, të cilët nga 105 vota nga organizata anëtare, u zgjodhën: Iliriana Gashi- 51 vota, Zana Hoxha Krasniqi- 48 vota, Luljeta Demolli- 47 vota dhe Bujar Kadriu- 40 vota.

Sfidat Kryesore që u diskutuan në Kuvend



Pagesa e anëtarësisë në CiviKos- Një pjesë e konsiderueshme e organizatave anëtare nuk e kanë paguar anëtarësinë.

Zbatimi i Kodit Etik të CiviKos- Kodi Etik për periudhën 3 vjeçare pas hyrjes në fuqi në vitin 2014 nuk ka qenë sanksionues por promovues. Në Kuvendin e ardhshëm do të vendoset nëse ky Kod do të jetë sanksionues.

Mungesa e fondeve për organizata të shoqërisë civile- Një ndër sfidat që disa organizata i ngritën gjatë këtij Kuvendi ishte edhe mungesa e fondeve për organizata të shoqërisë civile si dhe mungesa e kapaciteteve nga OSHC-të.

CiviKos organizon takim konsultative me organizatat e shoqërisë civile nëpër Komuna

Sekretariati i Platformës CiviKos me mbështetje të TACSO zyra në Kosovë gjatë muajit prill 2017 ka organizuar takime konsultative në 5 regjione të Kosovës. Takimet janë organizuar në bashkëpunim me organizatat partnere që shërbejnë si Qendra Regjionale të CiviKos si: CBM – Mitrovicë, INPO- Ferizaj, Syri i Vizionit - Pejë, Ec Ma Ndryshe- Prizren, NOPM - Gjilan, si dhe takimi i fundit është organizuar në Prishtinë.

Qëllimi i takimeve konsultative ishte njoftimi i organizatave të shoqërisë civile rreth zbatimit të deritanishëm të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013 – 2017 si dhe rreth përgatitjeve për përpilimin e Strategjisë së dytë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile.

STRATEGJIA E PLATFORMËS CIVIKOS 2018-2022

CiviKos ka përfunduar hartimin e Strategjisë së CiviKos për 2018 – 2021. Për këtë qëllim janë organizuar dy punëtori me një përbërje të gjërë të pjesëmarrësve, duke filluar nga Sekretariati i Platformës CiviKos, anëtarët e Bordit, përfaqësuesit e Qendrave Rajonale, përfaqësues të institucioneve si dhe të donatorëve. Këto punëtori kanë shërbyer si takime konsultimi për të lehtësuar një proces planifikimi strategjik me pjesëmarrje për të përditësuar misionin dhe vizionin e CiviKos-it sipas nevojës dhe për të identifikuar objektivat strategjike, rezultatet, treguesit kryesorë të performancës dhe rezultatet si dhe për të zhvilluar planin e aktiviteteve të CiviKos-it për të ndërlidhur strategjinë me aktivitetet e përditshme të organizatës.

Punëtorja e parë është mbajtur me 3-4 gusht 2017. Kjo punëtori kishte për qëllim të analizonte faktorët politikë, ekonomikë, socialë dhe teknologjikë relevantë për veprimtarinë e CiviKos, palët me interes që ndikojnë në punën e CiviKos, performancën aktuale të CiviKos, si dhe mundësitë dhe rreziqet për veprim në periudhën 2018-2022.

Punëtorja e dytë është mbajtur me 7-8 shtator 2017. Kjo punëtori shërbeu për zhvillimin e kornizës strategjike të CiviKosit.

Me disa takime të brendshme Strategjia e CiviKos 2018 – 2022 është finalizuar dhe pritet të aprovohet nga organizatat anëtare në fillim të vitit 2018.

PROCESI I PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË SHOQËRISË CIVILE NË TRUPA TË NDRYSHËM PUBLIK

Sekretariati i Platformës CiviKos gjatë vitit 2017 ka organizuar këto procese zgjedhore për përfaqësues të SHC-së në trupa të ndryshëm publik:

- Në Shkurt 2017, me kërkesë të Agjencionit Anti-Korrupsion CiviKos hap thirrjen për tre përfaqësues të shoqërisë civile në grupin punues për hartim të Strategjisë Anti korrupsion. Pasi

vetëm tre kandidat kishin shprehur interesim dhe i plotësonin kushtet nuk është organizuar proces i votimit.

- 27 Shkurt 2017 CiviKos hap thirrje për nominime nga OSHC-të për përfaqësues të SHC-së në grupin punues për vlerësimin e Ex-Post të Ligjit Nr. 04/I-175, ku të gjithë të interesuarit kanë marrë pjesë në proces.
- Mars 2017 – Me kërkesë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, CiviKos ka hapur thirrjen për për zgjedhjen e përfaqësuesit të rinjve në Bordin Drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor, ku në procesin e dytë të votimit është përzgjedhur kandidati që kishte më së shumti vota Zt. Arianit Jashari nga organizata iCHAT.
- Mars 2017- Me kërkesë të Ministrisë së Integritimit Evropian, CiviKos ka hapur thirrjen për përfaqësues të SHC-së në Komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve për Subvencionimin e Projekteve dhe Aktiviteteve që Promovojnë Procesin e Integritimit Evropian të Republikës së Kosovës.
- Mars 2017 – Me kërkesë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, CiviKos ka hapur thirrjen për përfaqësues të SHC-së në Komitetin e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Mars 2017, me kërkesë të Zyres së Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë, CiviKos ka hapur thirrjen për përfaqësues të SHC-së në Komisionin Rekomandues për shqyrtimin e CV-ve të kandidatëve aplikant për Bord Drejtues të PTK-së.
- Prill 2017, me kërkesë të Ministrisë së Financave, CiviKos hap thirrje për Përfaqësues të SHC-së në Grupin Punues për hartimin e Projekt Rregullores për Udhëtime Zyrtare.
- Maj 2017, me kërkesë të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, CiviKos ka hapur thirrjen për përfaqësues të SHC-së në cilësinë e vëzhguesve të punës së Komisioneve për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për familjet që janë raste sociale, dhe Komisionin për përzgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dala nga lifta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta nga këto kategori.
- Gusht 2017, me kërkesë të Ministrisë së Financave, CiviKos ka organizuar procesin e përzgjedhjes për përfaqësuesin të SHC në Grupin Punues për hartimin e Projektligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe ato Jobankare.



PROMOVIMI I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM (SDG) NGA ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

CiviKos gjatë vitit 2017 në koordinim me UNKT, dhe Njësinë e Planifikimit Strategjik të Zyres së Kryeministrit, ka promovuar dhe avokuar tek institucionet e Kosovës për integrimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) në agjendën e zhvillimit të Kosovës, dhe si ka luajtur një rol aktiv në zbatimin e objektivave të parashikuara si në SDG dhe në legjislacionin e Kosovës, duke përfshirë monitorimin dhe prodhimin / menaxhimin e të dhënave.

Si pjesë e kësaj iniciative zyra e UNKT në Kosovë, së bashku me CiviKos ka organizuar vizitë studimore në Bratisllavë, Sllovakia. Vizita u organizua në koordinim me Fondacionin PONTIS nga Sllovakia dhe u ofroi pjesëmarrësve një mundësi për të vëzhguar praktikën më të mirë dhe për të marrë përvojën praktike të një vendi të BE-së dhe perspektivën e tyre në veprimet e SGD dhe përfshirjen e shoqërisë civile në këtë proces. Pjesëmarrësit përveç përvojës se si shoqëria civile në Sllovakia janë të angazhuar në zbatimin e SDG-ve, ata patën mundësinë të krijojnë partneritete të ardhshme për bashkëpunim në arritjen e SDG-ve.

Poashtu gjatë muajit qershor 2017, CiviKos organizoi një punëtori rreth integritit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në punën e OSHC-ve në Kosovë, e cila u organizua pas vizitës studimore në Bratislavë, Sllovakia, me qëllim që të bëhet shkëmbim i përvojës së pjesëmarrësve dhe praktikave më të mira si dhe përvojën e një shteti anëtare të BE-së dhe perspektivën e tyre në veprimet e SGD dhe përfshirjen e shoqërisë civile në këtë proces.

ANGAZHIMI I CIVIKOS NË PROJEKTIN E USAID KOMUNAT TRANSPARENTE, EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE (TEAM)



CiviKos gjatë pjesës së dytë të vitit 2017 është nën-kontraktuar nga DAI- kontraktor i USAID për zbatimin e aktiviteteve të Komponentës së tretë – Mundësimi i Shoqërisë Civile për të hulumtuar dhe raportuar mbi korrupsionin, si pjesë e projektit Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (TEAM).



CiviKos ka hapur thirrje për organizatat anëtare që punojnë në fushën e prokurimit publik që të dërgojnë propozimet e tyre për ofrim të trajnimeve për organizatat të shoqërisë civile. Të gjitha organizatat anëtare që kanë shprehur interesimin e tyre, dhe i kanë plotësuar kriteret e parapara janë angazhuar për të ofruar këto trajnime.

Si pjesë e këtij projekti, CiviKos ka organizuar një sërë trajnimesh mbi Monitorimin e Prokurimit Publik, gjegjësisht 5 trajnime të organizuara gjatë periudhës tetor – dhjetor

2017, e që u mbajtën në Prishtinë, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren.

Përmes këtyre trajnimeve, më shumë se 100 organizata të shoqërisë civile kanë përfituar njohurinë se si të monitorojnë procesin e prokurimit nëpër komunat e tyre, si të raportojnë të gjeturat e tyre dhe si të avokojnë për një proces transparent të prokurimit publik.

Gjatë vitit 2018 CiviKos do të vazhdoj me trajnime në të gjitha regjionet e Kosovës rreth monitorimit të prokurimit publik, si dhe bashkëpunimit media-shoqëri civile.